



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:093026  
Datë: 20.12.2023  
Numri i dokumentit: 05096585

**C-III-15-0504**

Paditësi: D A nga Gracanica,

Kundër

Të paditur: NSH “Ratar”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. „Driton Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimi, Kolegji i Specializuar i përbërë me gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtaret Gazmend Sylaj dhe Manushe Karaqi me 20 dhjetor 2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Ankesa/Kërkesa e paditësit, D A, kundër Vendimit të AKP /AL për NSH “Ratar”, PRN115-0316, dt. 10.06.2015, konsiderohet e tërhequr.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 10.08.2015, paditësi në DHPGJS ka dorëzuar ankesën/padinë kundër Vendimit të AL të AKP-së, për NSH “Ratar”, PRN115-0316, dt. 10.06.2015, me të cilin është refuzuar kërkesa për kthimin e pronave të paluajtshme dhe njohjen e të drejtës së pronësisë.

Ankesës i ka bashkangjitur:

- Kopjen e Certifikatave të pronës.
- Deklaratën nen betim OPR.red.br.2028/2015.
- Kopjen e Kontratës të vitit 1984.
- Certifikatën e vdekjes për A Zh.
- Vendimin e AL-së.

Më 24.02.2021, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- III- 15-0504 për paditësin/ankuesin, me të cilin i ka kërkuar të plotëson ankesën kundër vendimit të AL dhe të dorëzoj provat në ekzemplar të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët e paditura, atë në pikëpamje subjektivë se a ka legjitimitet të plotë aktiv, të tregon shkaqet e ankesës kundër vendimit të AL-së të gjitha provat mbi bazën e të cilave ka ushtruar kërkesën, dhe të dorëzoj provat që kanë të bëjnë me identifikimin e ngastrës me ekspertizën gjeodezike, dhe të tregoj historiatin e pronës. Po ashtu, është udhëzuar të angazhoj Avokat nga radhët e Odes së Avokatëve të Kosovës, që ti mbroj të drejtat dhe interesat e tij.. Gjykata me urdhër ka kërkuar që të paguhet taks gjyqësore. Paditësi është njoftuar për pasojën juridike të mos veprimit.

Më dt. 26.05.2021, paditësit ju është dorëzuar urdhri, përmes postës

### **Arsyetimi ligjor**

**Ankesa/ kërkesa e paditësit, konsiderohet e tërhequr.**

**Paditësi nuk e ka paguar taksen gjyqësore .**

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditëses i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimit i urdhrit të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndhimës Ligjore nga Zyra për Ndhimë Juridike.

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, ashtu që sipas neni 13 të Udhëzimit Administrativë nr. 01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore është caktuar taksa në lartësi 100 €.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas neni 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi/ankuesi përmes Urdhrit, dt. 24.02.2021,, të cilin e ka pranuar më dt. 26.05.2021 u informua për faktin se në bazë të neni 253.5 të LPK-së, në rast të mos pagesës së taksës, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar të tërhequr ankesën.

Meqenëse paditësi, deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, sikundër nuk ka kërkuar ndonjë afat shtesë , gjykata në kuptim të dispozitës së neni 253. 5 të LPK-së, ankesën/ kërkesën e paditësit e konsideroi të tërhequr.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë, me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Gazmend Sylaj, Gjyqtar

Manushe Karaqi, Gjyqtar